

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“2AS INVEST” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më date 02.06.2021 une, i nenshkruari:

1. **SUHEJL TIKVINA**, lindur ne Shijak-Durres, i datëlindjes 22.05.1998, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti J80522013M

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“2AS INVEST” SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Shijak, Xhafzotaj, Autostrada DR-TR Km. 10, Zona Kadastrale 1242, Godine me nr. Pasurie 39/85, Durrës.

Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

Aktivitet në fushën e ndërtimit. Ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime industriale, turistike, bujqësore, rikonstruksione, ndërtim banesash me skelet. Ndërtime rrugore. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrada, pista, aeroporte, heliporte. Ndërtime hekurudhore, punime hekurudhore, punime speciale të shinave dhe traversave, punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit. Ndërtim ura dhe vepra arti, ekstakada ura metalike të varura, ndërtim tunele rrugore - hekurudhore, ndërtime detare, ndërtime portuale, bankina, basene, pontile, punime thellimi-drenimi. Ndërtime hidraulike e hidroteknike, ndërtime ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik, çimentime, etj. Ndërtim impiante të sistemit të ujit, ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës, ndërtim diga të larta, përforcime themeli e punime nëntokësore, izolime mbi dhe nëntokësore nga ujrat, themele të veçanta. Punime restaurimi, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike. Punime karpenterie. Punime shërbimi, punime në sipërfaqe të gjelbërta, parqe, pyje, pastrimi i sipërfaqeve urbane, mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndriçimi e sinjalizimi urban. Prodhim, përpunim, ruajtje, konservim dhe paketim të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme përfshirë mbetjet spitalore dhe ato të rrezikshme. Ndërtim i linjave të shfrytëzimit dhe pasurimit të ujit të pijshëm si dhe tregtimit të tij. Shërbime pastrimi të ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe shërbime DDD (Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) si dhe tregtim materialeve pastrimi. Ndërtimi i stacioneve të furnizimit me karburantit, pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve, magazinim dhe trajtim i mbetjeve të ujërave të zeza urbane.

Tregtimin e materialeve të ndërtimit të prodhuara nga shfrytëzimi, përpunimi dhe prodhimi i burimeve minerale, mermereve, graniteve, gur dekorativ etj. Prodhim betoni, prodhim parafabrikate betoni.

Shitje-blerje automjetesh, autovetura, eskavator, kamiona, kamioncina, import-eksport, makineri të rënda etj.

Tregtim tubash betoni dhe materiale ndërtimi.

Tregtim të artikujve të ndryshëm me pakicë e shumicë, industriale e ushqimore, bujqësore, blegtorale, lëngjeve të frutave, pijeve alkoolike, ujit, si dhe eksporti i tyre.

Prodhim dhe tregtim lule dhe pemë dekorative.

Blerje dhe tregtim materialesh hidraulike dhe elektrike.

Prokurime të ndryshme. Pjesëmarrje në tendera, prokurime dhe panaire të ndryshme

Veprimtari në fushën e turizmit, me qëllim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike të pushimit, plazheve, qendrave të argëtimit brenda dhe jashtë vendit, të blejë, të marrë me qera, të ndërtojë apo të nxisë ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë e vetme apo me partnerë të tjerë.

Transport mallrash e pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit.

Çdo lloj veprimtarie të ligjshme dhe të lejueshme e cila nuk ndalohet me ligj

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 10.000(dhjetemije) lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

SUHEJL TIKVINA është zotërues i 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerë 10.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë SUHEJL TIKVINA për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

SUHEJL TIKVINA

